



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

PROÇESVERBAL

Nr.20, datë 12.11.2021

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Nëntor, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 12.11.2021

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Rradhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Znj.Emiriana Sako, që kryen funksionet e Kryetarit Bashkisë, Zëvendëskryetari z.Gentian Kallmi dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje të gjithëve ! Të nderuar Këshilltarë! I nderuar Nënkyetar i Bashkisë! Uroj që të jeni mirë të gjithë familjarisht.

E deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak Durrës me mjete të komunikimit elektronik. Kjo mbledhje, siç jeni njoftuar me email është kërkuar nga Znj.Emiriana Sako, që kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë.

Ftoj Sekretaren e Këshillit Bashkiak të bëj prezencën online.

Dorina Milja: Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent...ok....etj.... Alfred Mullaraj ka votuar me email.....deri te Morena Boja..... jo për momentin (*flet Eneida që shikon kush janë online*).

Atëherë Kryetar u dëgjuan online 31 këshilltarë dhe 10 vota i ke me email (*p.s....u dëgjuan gjatë apelit 31 këshilltarë, pas shikimit te skype ka hyrë me vonesë dhe A.Bakaj dhe I.Cërloj, pra 33 këshilltarë online*).

Ani Dyrmishi: Faleminderit Dorina. Atëherë meqë kuorumi është i pranishëm kalojmë në rendin e ditës dhe miratimin e tij. Siç të gjithë jemi njoftuar me email sot kemi 4 pika të shtruara për miratim në rendin e ditës:

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TABELËS SË OBJEKTEVE PËR PËRFORCIM, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 137, DATË 28.10.2021 “PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 561’411’457 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 613, DATË 20.10.2021 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË DURRËS”
2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SHTATË TË 11 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL
3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 2, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1032, RRUGA “ALEKS KOMENI” DHE PALLATIN “KASTRATI”, RRUGA “RAMADAN VELIU”, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË SHESHIT PARA MAUZOLEUMIT TË DËSHMORËVE ME EMRIN “JORGJI ZIU”, NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS

Përsa i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

.....(ndërkohë qetësi, po votohet në chat)...

Kundra? Apstenim? Ju lutem votoni kush nuk ka votuar ende.

Atëherë Eneida mund të ma konfirmosh është mbyllur votimi?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Kolegët kanë votuar pro rendin e ditës.

Ani Dyrmishi : Atëherë faleminderit. Me të gjitha votat pro miratohet dhe rendi i ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave, znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Faleminderit z. Kryetar. Mirëdita të gjithëve!

Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin e përgatitur nga drejtoritë përkatëse , vendosi pro miratimit të kësaj pike dhe kalimin për votim nga të gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit Bashkiak. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Bardhaj.

I japim fjalën Komisionit Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar! Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë dhe propozon miratimin në seancën e sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z.Jani!

Komente përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës nga ana e këshilltarëve kemi ?Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim . Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

.....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra? Apstenim?..... Ju lutem votoni kush nuk ka votuar ende.

Ju lutem, kush nuk ka votuar ende të votojë...

Atëherë Eneida ma konfirmon nëse është mbyllur votimi?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Kolegët kanë votuar pro pikës 1.

Ani Dyrmishi : Atëherë me vota unanime miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Faleminderit Kryetar ! Përshëndetje !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon për ta kaluar pikën 2 të rendit të ditës në mënyrë unanime. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Roshi. Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Po Kryetar, faleminderit !

Edhe për pikën 2, Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Jani.

Ka komente përsa i përket pikës 2 nga ana e këshilltarëve ? Nuk ka, atëherë kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

.....(ndërkohë qetësi... votohet në chat) .

Kundra?.... Apstenim ? ...

Eni ma konfirmon është mbyllur votimi?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Ende nuk është mbyllur.

Ani Dyrmishi : Ju lutem votojmë kush nuk ka votuar ende ...

Atëherë është mbyllur votimi Eni?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Kolegët kanë votuar pro pikës 2.

Ani Dyrmishi : *Atëherë me të gjitha votat unanime miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 3**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon për pikën 3 në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Roshi. Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar!

Edhe për pikën 3, Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Atëherë përsa i përket pikës 3 nga ana e këshilltarëve të tjerë kemi ndonjë koment ? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

.....(ndërkohë qetësi...votohet në chat)

Kundra?... Apstenim ? ...

Ju lutem votoni të gjithë kush nuk ka votuar.

Atëherë Eni ma konfirmon është mbyllur procesi?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Ende jo.

Ani Dyrmishi : Atëherë Eni, mund të ma konfirmosh?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Kolegët kanë votuar pro pikës 3.

Ani Dyrmishi : *Atëherë faleminderit. Me vota unanime miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.*

- Kalojmë në **projektvendimin e pikës 4**, i japim fjalën Komisionit Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj. Jolanda Mustafaraj. Zonja Mustafaraj?.....

Eneida Marku (asistenca teknike) : Landa, të lutem hap mikrofonin.

Ani Dyrmishi : Po Landa, mund të flasësh.

Jolanda Mustafaraj: Përshëndetje! Më dëgjon.

Ani Dyrmishi : Po.

Jolanda Mustafaraj: Komisioni Arsimit, Rinisë dhe Sporteve ra dakort për pikën 4, për emërtimin e sheshit para Mauzoleumit të Dëshmorëve me emrin të Jorgji Ziu-t.

Ani Dyrmishi : Atëherë komente përsa i përket pikës 4, ka nga ana e këshilltarëve ? Nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

.....(ndërkohë qetësi...votohet në chat)

Kundra ?.... Apstenim ? ...

Ju lutem votoni të gjithë....

Atëherë Eneida ma konfirmon është mbyllur procesi?

Eneida Marku (asistenca teknike) : Kolegët kanë votuar pro pikës 4.

Ani Dyrmishi : Atëherë, me asnjë votë kundra, asnjë apstenim, me vota unanime pro miratohet dhe pika 4 e rendit ditës.

Nëse Kryetarja do të marri fjalën.

Emiriana Sako : Ju falenderoj.

Sot është dhe një moment i rëndësishëm dhe për Këshillin Bashkiak përsa i takon emërtimit të sheshit në emër të dëshmorit që vendosëm me miratimin tuaj.

Faleminderit . Ju uroj punë të mbarë.

Ani Dyrmishi: Faleminderit Kryetare. Faleminderit të gjithë Këshilltarëve!

Duke Ju kujtuar që mbledhjen e radhës do njoftoheni nga ana e Sekretariatit të Këshillit, Ju falenderoj për pjesmarrjen dhe Ju uroj një fundjavë të mbarë.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit.

Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 5(pesë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI